



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

KOMISIONERI PËR MBROJTJEN NGA DISKRIMINIMI

Nr. 1286/1 prot.

Tiranë, më 9. 09. 2019

Lënda: **Dërgohen rekomandime për projektligjin “Për disa shtesa në Ligjin Nr. 71/2016 “Për Kontrollin Kufitar”.**

Z. SANDËR LLESHAJ
MINISTËR
MINISTRIA E BRENDSHME
Adresa: Sheshi “Skënderbej”, nr. 3

T I R A N Ë

I nderuar zoti Ministër,

Në vijim të shkresës Tuaj nr. 6837/1 Prot, datë 27.08.2019, me lëndë “Dërgohet projektligj përmendim”, protokolluar me tonën me Nr. 1286, datë 28.08.2019, po ju përcjellim në vijim rekomandimet apo mendimet e Komisionerit për Mbrojtjen nga Diskriminimi, lidhur me projektligjin “Për disa shtesa në Ligjin Nr. 71/2016 “Për Kontrollin Kufitar”.

Dëshirojmë të theksojmë paraprakisht se, Komisioneri për Mbrojtjen nga Diskriminimi vlerëson pozitivisht nismën e ndërmarrë nga ana e Ministrisë së Brendshme për hartimin e një projektligji “Për disa shtesa në Ligjin Nr. 71/2016 “Për Kontrollin Kufitar”, i cili synon harmonizimin e kuadrit ligjor shqiptar me atë evropian, në këtë fushë.

Komisioneri për Mbrojtjen nga Diskriminimi, si institucion i pavarur, i cili siguron mbrojtjen efektive nga diskriminimi dhe nga çdo formë sjellje që nxit diskriminimin, në ushtrim të kompetencës të parashikuar në nenin 32, pika 1, germa “ë”, të Ligjit Nr. 10 221 datë 04.02.2010 “Për mbrojtjen nga diskriminimi”, ku sanksionohet se: “Komisioneri ka kompetencë t'u bëjë rekomandime autoriteteve kompetente, sidomos duke propozuar miratimin e legjisacionit të ri, ose ndryshimin apo reformimin e legjisacionit ekzistues”, pasi u njoh me projektligjin sipërcituar, sjell në vijim, në vëmendjen Tuaj, disa çështje dhe rekomandime që paraqesin rëndësi në lidhje me këtë projekt-akt.

Duke qenë se ky projektligj, sikurse rezulton edhe nga relacioni i tij, është përafruar me Direktivën 2004/82 të Këshillit Evropian të datës 29 Prill 2004 dhe Direktivën 2016/681 të Parlamentit dhe Këshillit Evropian të datës 27 Prill 2016, Komisioneri për Mbrojtjen nga Diskriminimi propozon disa ndryshime në projektligjin “*Për disa shtesa në Ligjin Nr. 71/2016 “Për Kontrollin Kufitar”*”, si vijon:

Së pari, rekomandojmë që, në nenin 2 të projektligjit, të shtohet një pikë tjetër, ku të jepet përkufizimi i termit “*pasagjer*”, në përputhje me nenin 3 (4) te Direktivës 2016/681 të Parlamentit dhe Këshillit European “*Mbi përdorimin e të dhënave të regjistrat të emrave të pasagjerëve për parandalimin, zbulimin dhe ndjekjen e veprave penale me qëllime terroriste dhe kime të rënda*”¹. Mendojmë se ky përkufizim është i nevojshëm që të parashikohet në Ligjin 71/2016 “*Për Kontrollin Kufitar*”, duke qenë se të gjitha ndryshimet ligjore që parashikohet të shtohen, nëpërmjet projektligjit në fjalë, kanë të bëjnë me këtë term si dhe do të ishte në përputhje të plotë me Direktivën me të cilën synon të përafrohet. Gjithashtu, referuar nenit 1 të projektligjit, sipas të cilit synohet të shtohet objekti i ligjit, duke parashikuar se: “*Ky ligj përcakton rregullat për regjin e kontrollit kufitar dhe transmetimin e të dhënave të pasagjerit, të personave që kalojnë kufirin shtetëror të Republikës së Shqipërisë*”, dikton nevojën për dhëni e përkufizimit të termit “*pasagjer*”, i cili është po aq i domosdoshëm sa edhe përkufizimet e tjera që janë vendosur në këtë projektligj.

Së dyti, rekomandojmë që, nën frymën e parashikimeve të Direktivës 2016/681 të Parlamentit dhe Këshillit European “*Mbi përdorimin e të dhënave të regjistrat të emrave të pasagjerëve për parandalimin, zbulimin dhe ndjekjen e veprave penale me qëllime terroriste dhe kime të rënda*”, të shtohet në projektligj një pikë, ku të parashikohet shprehimi i se: “**Ndalohet përpunimi i të dhënave të Regjistrat të emrit të Pasagjerit (PNR) që zbulojnë karakteristikat e personit, të cilat përbëjnë shkak diskriminimi sipas legjisacionit të posaçëm për mbrojtjen nga diskriminimi. Në rast se të dhënat e Regjistrat të emrit të Pasagjerit (PNR) që zbulojnë një informacion të tillë pranohen nga NIF, ato fshihen menjëherë.**”.

Së treti, rekomandojmë që, referuar parashikimeve në pjesën hyrëse të Direktivës 2016/681 të Parlamentit dhe Këshillit European “*Mbi përdorimin e të dhënave të regjistrat të emrave të pasagjerëve për parandalimin, zbulimin dhe ndjekjen e veprave penale me qëllime terroriste dhe kime të rënda*”, të shtohet një pikë në projektligj, sipas së cilës të parashikohet shprehimi i se: “*Në përputhje me parimin e mbrojtjes së të dhënave personale dhe mbrojtjes nga diskriminimi, nuk duhet të merret asnjë vendim që prodhon efekt të pafavorshëm mbi një person ose ndikon ndjeshëm tek ai, vetëm nëse bëhet për shkak të përpunimit të automatizuar të të dhënave te Regjistrat të emrit të Pasagjerit (PNR). Një vendim i tillë nuk duhet të*

¹ Neni 3 (4) i Direktivës (EU) 2016/681, parashikon: “*Passenger’ means any person, including persons in transfer or transit and excluding members of the crew, carried or to be carried in an aircraft with the consent of the air carrier, such consent being manifested by that person’s registration in the passengers list.*”

diskriminojë personin për shkaqet e mbrojtura të diskriminimi, sipas parashikimeve të ligjit për mbrojtjen nga diskriminimi".²

Së katërti, rekomandojmë që, në nenin 19/2 të projektligjit, pika 2, germa (n) të bëhet një modifikim në formulim, në kuptimin e teknikës legislative. Kështu, ne sugerojmë që, nga "...emrin dhe detajet e kontaktit të kujdestarit gjatë nisjes dhe marrëdhënies me të miturin, emrin dhe detajet e kontaktit të kujdestari gjatë mbërritjes dhe marrëdhënies me te miturin...", të bëhet: "...emrin dhe detajet e kontaktit të kujdestarit në nisje dhe lidhja/marrëdhënia e tij me të miturin, emrin dhe detajet e kontaktit të kujdestarit në mbërritje dhe lidhja/marrëdhënia e tij me të miturin"³".

Duke Ju falenderuar për bashkëpunimin, besojmë në ndërhyrjen Tuaj, me qëllim reflektimin në projektligj të rekomandimeve si më sipër.

KOMISIONERI



² Përkthim i Komisionerit. Direktiva parashikon shprehimisht: *Taking fully into consideration the right to the protection of personal data and the right to non-discrimination, no decision that produces an adverse legal effect on a person or significantly affects that person should be taken only by reason of the automated processing of PNR data. Moreover, in respect of Articles 8 and 21 of the Charter, no such decision should discriminate on any grounds such as a person's sex, race, colour, ethnic or social origin, genetic features, language, religion or belief, political or any other opinion, membership of a national minority, property, birth, disability, age or sexual orientation.*

³ Aneks 1 i Direktivës (EU) 2016/681,parashikon: "12. General remarks (including all available information on unaccompanied minors under 18 years, such as name and gender of the minor, age, language(s) spoken, name and contact details of guardian on departure and relationship to the minor, name and contact details of guardian on arrival and relationship to the minor, departure and arrival agent)"

